

VENDIM

Nr. 477, datë 25.7.2012

PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE DHE TEKNIKËVE FLUTURUES ME HELIKOPTER, NË PENSION, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT DHE GARDËN E REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 3 e 8 të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit dhe i Gardës së Republikës, në funksionet pilot dhe teknik fluturues të helikopterëve, që trajtohen nga ligji nr. 9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar, me daljen në pension duhet të tërheqë nga dega e sigurimeve shoqërore dy formularë kërkesë për përfitim, të cilat i dorëzon në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Gardën e Republikës apo në njësinë buxhetore ku ka punuar deri në periudhën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, si dhe në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore ku ka vendbanimin.

2. Dokumentacioni i plotë për përfitimin e trajtimit të veçantë përgatitet nga strukturat e burimeve njerëzore dhe të financës të njësisë buxhetore, i dërgohet për shqyrtim, sipas përkatësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo Gardës së Republikës dhe këto ia dërgojnë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore.

3. Për llogaritjen e trajtimit financiar merret si bazë paga referuese, e njësuar me pagën referuese të funksionit organik të pilotit ose të teknikut aktiv në njësinë e helikopterëve të Policisë së Shtetit ose të Gardës së Republikës, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për këtë trajtim financiar.

Paga referuese për përfituesin përfshin:

- a) pagën bazë për gradë;
- b) shtesën për natyrë të veçantë pune e shërbimi;
- c) shtesën për vjetërsi në punë;
- ç) shtesën për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin;
- d) shtesën mesatare të fluturimeve vjetore.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzuesit dhe të dokumentacionit tip për zbatimin e këtij vendimi dhe për dhënien e shtesave mbi pension.

5. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

